



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:070129

Datë: 20.04.2023

Numri i dokumentit: 04209506

P.nr.272/23

GJYKATA THEMELORE PEJË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Leon Përlaska, me procesmbajtëse Shpresa Kërnye në çështjen penale kundër të pandehurit S. M. nga Peja, për shkak të veprës penale Dhune ne familje nga neni 248 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës me propozim për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik ne liri të Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.553/23 të datës 06.04.2023, jashtë seancës me datë 20.04.2023, mori këtë:

AKTVENDIM

Ndaj të pandehurit:

S. S. M., i lindur me në Pejë, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me numër

- I. PUSHOHET PROCEDURA PENALE për shkak të veprës penale Dhunë në familje nga neni 248 par.1 të KPRK-së sipas aktakuzës me propozim për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik ne liri të Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.553/23, për shkak se i pandehuri nuk është i aftë për t'iu nënshtruar gjykimit.
- II. SHPENZIMET E PROCEDURËS mbeten në barrën e mjeteve buxhetore te gjykatës.

ARSYETIM

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzës së bashku me propozim për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik ne liri PP/II.nr.553/23 të datës 06.04.2023, kundër të pandehurit S. M. për shkak të veprës penale Dhune në familje nga neni 248 par.1 të KPRK-së.

Gjykata me datë 14.04.2023 e mbajti seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën seancë prezantuan prokurori i shtetit Dorjan Juniku, i pandehuri S. M. dhe mbrojtësi i tij Av.Arben Kelmendi, i dëmtuari S. M. dhe eksperti psikiatër Dr.M.H..

Gjykata fillimisht e mori mendimin e ekspertit psikiatër në lidhje me faktin nëse i pandehuri është i aftë për të përballur gjykimin ku eksperti nder të tjera deklaroi se: “I pandehuri nuk është i aftë të mbroj vetën, nuk është i aftë të konsultohet me mbrojtësin dhe kjo gjendje mendore e të pandehurit është e përhershme dhe e pandryshueshme”.

Ky mendim i ekspertit mbështetet edhe nga raporti i ekspertizës psikiatrike i përpiluar nga grupi i ekspertëve i datës 31.03.2023.

Pas dëgjimit të ekspertit psikiatër gjykata e mori mendimin e prokurorit të shtetit, të dëmtuarit dhe mbrojtësit të të pandehurit, të cilët duke u bazuar ne mendimin e ekspertit psikiatër i propozuan gjykatës qe procedura penale ndaj të pandehurit të pushohet.

Gjykata, duke pasur parasysh situatën e larte përshkruar dhe faktin se i pandehuri nuk është i aftë për të përcjellë gjykimin, në kuptim të nenit 510 dhe 511 të KPPRK-së mori aktvendim qe ndaj të pandehurit S. M. të pushohet procedura penale.

Andaj, duke u bazuar në faktet e parashtruara, provat e referuara dhe bazën ligjore te lartpërmendur u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PËJË

Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.272/23, dt.20.04.2023

Gjyqtari i vetëm gjykues:
Leon Përlaska

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të ushtroj ankesë në afat prej 3 ditësh nga pranimi i të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.